STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 19 prill 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) DREJTON MBI 8 MILIONE DOLLARE NE FONDE FEDERALE PER TE RIMBURSUAR VENDET E PREKURA NGA SUPER STUHIA SENDI (SANDY) PER KOSTOT E PASTRIMIT

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka siguruar mbi 8 milionë dollarë për rajonet e prekura nga super stuhia Sendi (Sandy) për rimbursimin e kostove për pastrimin pas stuhisë. Vendet që do të marrin këto fonde të miratuara nga FEMA përfshijnë: Fshatin e Amitivill (Village of Amityville), Qarku Safolk (Suffolk County); Fshatin e Babilon (Village of Babylon) në Qarkun Safolk (Suffolk County); Qytezën e Hantingtën (Town of Huntington), Qarku Safolk (Suffolk Couny); Qytezë e Sauthhemptën (Town of Southampton), Qarku Safolk (Suffolk County); Qytezën e Bedford (Town of Bedford), Qarku Uestçestër (Westchester County); dhe Kopshtet Botanike të Nju Jorkut (New York Botanical Gardens) në Bronks (Bronx).

“Super stuhia Sendi (Sandy) la dëmtim të rëndë të përhapur gjërësisht anembanë komuniteteve që ishin në rrugën e saj,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Pasoja ishte si fizike, ashtu edhe financiare. Vendeve iu desh te reagonin shpejt pas stuhisë për të pastruar shkatërrimin dhe mbeturinat e lëna pas dhe kostot për t’a bërë këtë ishin shumë të mëdha. Ndërsa vazhdojmë të rimëkëmbemi dhe të rindërtojmë, jam i gëzuar të jem në gjendje që të drejtoj këto fonde të rëndësishme federale për të rimbursuar ata që u prekën nga stuhia.”

“Rikthimi i komuniteteve të dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy) është përparësia më e lartë e departamentit tonë dhe këto fonde të rimbursimit të Ndihmës Publike do të ndihmojnë secilin nga komunitetet e prekura që të rivendosin në rregull punët fiskale të tyre,” tha Komisioneri i Seksionit të Sigurisë së Atdheut dhe Shërbimeve të Urgjencës të NYS-së (NYS Division of Homeland Security and Emergency Services Commisioner) Xherom M. Hauër (Jerome M. Hauer).

Dhënia e këtyre fondeve federale është pjesë e rimbursimeve në vazhdim dhe në pritje në të ardhmen që shteti do të administrojë dhe paguajë tek komunat e prekura. Komunat janë duke u rimbursuar mbështetur në një shumëllojshmëri projektesh që përfshijnë ndërtimin dhe shkatërrimin, heqjen e mbeturinave ranore dhe bimore, aktivizime të EOC-së, largime, kontrolle dhe riparime dhe rivendosje emergjente të teknologjisë së informacionit dhe programin Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (Sheltering and Temporary Essential Power) (STEP). Shteti do të vazhdojë t’i bëjë këto pagesa të rimbursimeve ndërsa FEMA jep fondet.

Qyteza e Hantingtën (Town of Huntington), Qarku Safolk (Suffolk Couny)

Qyteza e Hantingtën (Town of Huntington) në Qarkun Safolk (Suffolk County) është duke marë 4,079,266 dollarë. Kostot e pësuara nga Qyteza pas stuhisë ishin për shpenzime të punës, pajisjeve dhe kontratave në lidhje me heqjen e pemëve, degëve dhe linjave të korrentit të rrëzuara dhe rërës së ndotur, që shkaktuan kushte të rrezikshme të përhapura gjerësisht.

“Super stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi dëm të konsiderueshëm në qytezën e Hantingtën (Huntington) dhe shkatërroi shumë prej komuniteteve të saj. Punëtorët, zyrtarët dhe punonjësit e urgjencës të Qytezës punuan pa lodhje duke hequr mbeturinat pas stuhisë, një përpjekje që u vërtetua të jetë shumë e kushtueshme,” tha Senatori Karl. L. Marçelino (Carl L. Marcellino). “Ky rimbursim do të bëjë mjaft për të siguruar se taksapaguesit në Hantingtën nuk do të duhet të mbajnë të gjitha shpenzimet. Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për veprimin e tij të shpejtë në drejtimin e atyre fondeve.”

Anëtari i Asamblesë Çed A. Lupinaçi (Chad A. Lupinacci) tha, “Si shumë pjesë të Long Ajlënd (Long Island), Qyteza e Hantingtën (Town of Huntington) nuk u kursye nga forca shkatërruese e jashtëzakonshme e super stuhisë Sendi (Sandy). Mbërritja e këtyre fondeve të miratuara nga FEMA nuk mund të kishte ardhur në një kohë më të mirë. Banorët e Hantingtënit janë gati për t’a lënë Sendin (Sandy) pas dhe për t’iu kthyer punëve si zakonisht.”

Qyteza e Sauthhemptën (Town of Southampton), Qarku Safolk (Suffolk County)

Qyteza e Sauthhemptën (Town of Southampton) në Qarkun Safolk (Suffolk County) është duke marë 1,512,091 dollarë. Gjatë Sendit (Sandy), erë të forta dhe shira të dendur rrëzuan pemë e linja të korrentit dhe përmbytje lidhur me to në zonat e ulta shkaktuan kushte të rrezikshme dhe mungesa të korrentit anembanë Qytezës. Mbi 100,000 jardë kub mbeturina pemësh dhe mbeturina te përziera bimore u depozituan përreth Qytezës, të cilat u hoqën nga ekipet e komunës dhe të kontraktuara, përfshirë përdorimin e pajisjeve me qira për të përshpejtuar procesin e pastrimit.

“Vendosja e dollarëve të rimëkëmbjes në duart e komunave vendore është mjaft e rëndëssihme -- dhe dyfish e rëndësishme për Sauthhemptën, ku sezoni turistik që nxit ekonominë është gati për të filluar,” tha Senatori Keneth P. LaVale (Kenneth P. LaValle), që është një anëtar i Nën-Komisionit për Buxhetin e Sendit të Senatit (Sandy Budget Sub-Committee).

Anëtari i Asamblesë Fred W. Tiele, Jr. (Fred W. Thiele, Jr.) tha, “Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për punën në ndihmë të Qytezës së Sauthhemptonit. Si një komunitet me shumë pak arterie kryesore, rrugët duhet të pastroheshin sa më shpejt që të ishte e mundur për të lejuar kalimin e automjeteve të urgjencës dhe të personave të larguar, pa pyetur për kostot. Jemi mirënjohës për këtë rimbursim të FEMA-s.”

Fshati i Babilon (Village of Babylon), Qarku Safolk (Suffolk County)

Fshati i Babilon (Village of Babylon), Qarku Safolk (Suffolk County) është duke marë 832,604 dollarë. Gjatë Sendit (Sandy), përmbytje, era të forta, valë të forta të baticës dhe shiu shkaktuan dëme të përhapura gjerësisht dhe trotuaret e kthesat u ngritën nga pemët e shkulura me rrënjë prej erave me forcë të uraganit. Fshatit iu desh të merrte me qira pajisje për të ndihmuar me mbledhjen dhe heqjen e mbeturinave, që ishin të përbëra nga rreth 2,500 tonë mbeturina të ndërtimit dhe shkatërrimit, si dhe pothuajse 1,600 tonë të mbeturinave bimore. Përpjekjet e pastrimit u përfunduan nga forca e punës e Fshatit për të dyja llojet e mbeturinave.

Senatori Fil Boil (Phil Boyle) tha, “Komunat vendore vazhdojnë të përpiqen që të përballen me shpenzimet e papritura të pastrimit nga super stuhia Sendi (Sandy). Dëshiroj të falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për sigurimin e këtyre fondeve për Fshatin e Babilonit dhe jam i kënaqur që fondet e rimbursimit do të vazhdojnë të vijnë për komunitetet e tjera të shkatërruara ndërsa përpjekjet e pastrimit vazhdojnë.”

Anëtari i Asamblesë Jozef Saladino (Joseph Saladino) tha, “Gjëja më e rëndësishme që Shteti i Nju Jorkut (New York State) duhet të bëjë pikërisht tani është të sigurojë se komunat tona, banorët tanë dhe bizneset tona vendore, që janë viktima të super stuhisë Sendi (Sandy) marrin ndihmën që u nevojitet menjëherë. Kam kërkuar që kjo ndihmë të mbërrijë tek komunitetet tona sa më shpejt që të jetë e mundur dhe falënderoj dhe vlerësoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) që e ka dëgjuar atë thirrje. Fshati Babilon ka shpenzuar një sasi të stërmadhe parash për të mbrojtur banorët tanë dhe për të punuar që jeta të kthehet në normale. Jam shumë i motivuar për të vazhduar punën me Kryetarin Ralf Skordino (Ralph Scordino) për të siguuar se Albani (Albany) e bën punën e saj.”

Qyteza e Bedford (Town of Bedford), Qarku Uestçestër (Westchester County)

Qyteza e Bedford (Town of Bedford) në Qarkun Uestçestër (Westchester County) është duke marë 585,766 dollarë. Gjatë Sendit (Sandy), era shkaktuan mbeturina bimore të rrezikshme të përhapura gjerësisht, përfshirë pemë dhe degë të rrëzuara në rrugë, parqe publike dhe vendkalime. Qyteza përdori punën e komunës, të shtuar me punë të kontraktuar, për të hequr rreth 22,707 jardë kub të mbeturinave të pemëve dhe bimore nga rrugët dhe vendkalimet rrugore të Qytezës.

Senatori Xhorxh Latimer (George Latimer) tha, “Guvernatori Kuomo (Cuomo) duhet përgëzuar për sigurimin e ndihmës së nevojshme për njerëzit e Bedfordit (Bedford). Jemi thellësisht mirënjohës për mbështetjen dhe udhëheqjen e tij në ndihmë të këtij komuniteti.”

Anëtari i Asamblesë Dejvid Bukvald (David Buchwald) tha, “E pashë vetë dëmin e shkaktuar nga super stuhia Sendi (Sandy) në shtëpitë dhe bizneset e Bedfordit (Bedford), Bedford Hills dhe Katonah. Shpreh mirënjohjen time më të thellë për Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për drejtimin e këtyre fondeve federale në mënyrë që Qyteza e Bedfordit (Town of Bedford) të mund të vazhdojë të rindërtohet pas kësaj stuhie shkatërruese.”

Kopshtet Botanike të Nju Jorkut (New York Botanical Gardens), Bronks (Bronx)

Kopshtet Botanike të Nju Jorkut (New York Botanical Gardens) në Bronks (Bronx) janë duke marë 520,929 dollarë. Kostot e pësuara nga Kopshtet Botanike (Botanical Gardens) ishin për pastrimin dhe heqjen e rreth 5,000 yardë kub mbeturina bimore, përfshirë pemë të rrëzuara dhe rrugë, kalime dhe vendkalime të bllokuara, duke shkaktuar kushte të rrezikshme anembanë Vendit Historik Kombëtar të Rregjistruar (National Registered Historic Landmark).

Senatori Xhef Klain (Jeff Klein) tha, "Çdo vit, turistë nga anembanë bota vizitojnë rrethin tonë për të përjetuar bukurinë e verës në Kopshtin Botanik të Bronksit (Bronx Botanical Garden). Me këtë fond të rëndësishëm të rimëkëmbjes, përfundimisht mund të sigurohemi se një nga vendet historike për një kohë të gjatë të Bronksit (Bronx) së shpejti do të kthehet në lulëzim të plotë. Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) që u sigurua se nevojat e rrethit tonë u përmbushën edhe njëherë ndërsa vazhdojmë të rimëkëmbemi nga super stuhia Sendi (Sandy)."

Anëtari i Asamblesë Mark Gjonaj tha, "Kopshtet Botanike të Nju Jorkut (New York Botanical Gardens) janë të rëndësishme për zgjedhësit e mij, ashtu si për të gjithë banorët dhe vizitorët e Qytetit të Nju Jorkut (New York City). Eshtë vendimtare që t'i kemi këto fonde të caktuara për të rikthyer Kopshtet Botanike (Botanical Gardens) në kushtet përpara Sendit (Sandy). Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për fondet për të rindërtuar komunitetet tona dhe për t'a bërë këtë xhevahir të Bronksit (Bronx) që të shkëlqejë më fort sesa kurrë me parë."

Fshati i Amitivill (Village of Amityville), Qarku Safolk (Suffolk County)

Fshati i Amitivisll (Village of Amityville) në Qarkun Safolk (Suffolk County) është duke marë 483,450 dollarë. Kostot e pastrimit të Fshatit përfshinë heqjen, transportimin, depozitimin, pakësimin dhe eleminimin e rreth 2,300 tonë të mbeturinave të ndërtimit dhe shkatërrimit dhe rreth 1,300 tonë të mbeturinave bimore të përbëra nga pemë, degë dhe rrënjë të rrëzuara. Era të forta, së bashku me ngritjen e baticës, krijuan mbeturina të ndërtimit dhe shkatërrimit të përbëra nga dëmtime të jashtme dhe të brendshme, të cilat të gjitha u çuan në rrugët e fshatit për largim. Kostot për heqjen e mbeturinave përfshinë punën me kohë shtesë të punëtorëve të komunës dhe kontraktorëve që përdorën pajisjet e personelit të tyre. Fshati gjithashtu përdori pajisje me qira, me përdoruesit, për të ndihmuar në mbledhjen e mbeturinave. Mbeturinat e ndërtimit dhe shkatërrimit u dërguan në një vend të përkohëshëm. Mbeturinat bimore gjithashtu u dërguan në një vend të përkohëshëm të pakësimit të mbeturinave. Kontraktorët u pajtuan për të mbledhur mbeturina nga rrugët e Fshatit dhe për t'i dërguar mbeturinat në vendet përfundimtare të eleminimit të tyre.

Senatori Çarls J. Fushilo Jr. (Charles J. Fuschillo, Jr.) tha, "Super stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi dëmtim dhe shkatërrim të jashtëzakonshëm në Fshatin e Amitivill (Village of Amityville), duke lënë mijëra tonë mbeturina pas. Fshati shpenzoi burime të konsiderueshme për të hequr këto mbeturina në mënyrë që banorët dhe bizneset të mund të fillojnë të rimëkëmben dhe të rindërtojnë sa më shpejt që të jetë e

mundur. Këto fonde rimbursimi do të sjellin një përfitim të madh për Fshatin e Amitivill (Village of Amityville) dhe do të japin ndihmën shumë të nevojshme për përpjekjet e tij të vazhdueshme të rimëkëmbjes."

Anëtari i Asamblesë Robert K. Swini (Robert K. Sweeney) tha, "Pastrimi fillestar pas super stuhisë Sendi (Sandy) ishte një përpjekje e madh që kërkoi ndihmën e të gjithëve. Amitivill (Amityville) ishte në gjendje të mbështetej tek vullnetarët vendorë, organizatat qytetare dhe nëpunësit publikë të përkushtuar, përfshirë Guvernatorin Kuomo (Cuomo) gjatë stuhisë. Guvernatori është duke vazhduar të na ndihmojë duke u siguruar se pushteti vendor merr ndihmën federale që i nevojitet për përballuar kostot e pastrimit."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418